

UDHËZIM
Nr. 19, datë 17.9.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 33, DATË 24.9.2010 TË MINISTRIT TË
FINANCIVE “PËR TRAJTIMIN E KREDIVE TË TRANSFERUARA NGA BANKAT E
NIVELIT TË DYTË ME KAPITAL TËRËSISHT SHTETËROR NË AGJENCINË E TRAJTIMIT
TË KREDIVE, KRITERET DHE KUSHTET PËR NDRYSHIMIN E MARRËVESHJES SË
KREDISË, SI DHE PROCEDURAT E MARRJES NË PRONËSI TË PASURIVE TË LËNA SI
GARANCI OSE JO NGA HUAMARRËSIT, TË ADMINISTRIMIT, SHITJES DHE DHËNIES
ME QIRA APO ME ENFITEOZË TË KËTYRE PASURIVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 9731, datë 10.5.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8894, datë 14.5.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, të ndryshuar”, dhe pikës 1 kreu IV të vendimit nr. 681, datë 11.6.2009 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin e kredive të transferuara nga bankat e nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror në Agjencinë e Trajtimit të Kredive, për kriteret dhe kushtet për ndryshimin e marrëveshjes së kredisë, si dhe procedurat e marrjes në pronësi të pasurive të lëna si garanci ose jo nga huamarrësit, të administrimit, shitjes dhe dhënies me qira apo me enfiteozë të këtyre pasurive”, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 33, datë 24.9.2010 të Ministrit të Financave “Për trajtimin e kredive të transferuara nga bankat e nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror në Agjencinë e Trajtimit të Kredive, kriteret dhe kushtet për ndryshimin e marrëveshjes së kredisë, si dhe procedurat e marrjes në pronësi të pasurive të lëna si garanci ose jo nga huamarrësit të administrimit, shitjes dhe dhënies me qira apo me enfiteozë të këtyre pasurive”, të ndryshuar bëhet ky ndryshim:

1. Në kreun III, pika 26 ndryshohet si më poshtë:
26. “Komisioni i ankandit përbëhet nga kryetari dhe 4 anëtarë të cilët emërohen nga Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së.”.
2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Agjencia e Trajtimit të Kredive.
3. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCIVE
Ridvan Bode